



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni i Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 26.09.2016, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Vazhdim i diskutimit rreth projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë";

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Pandeli Majko, Ulsi Manja, Vasilika Hysi, Petrit Vasili, Vexhi Muçmataj.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Spartak Braho, Gent Strazimiri, Arben Ristani, Eduard Halimi.

Të ftuar:

Sokol Sadushi - Ekspert i Nivelit të Lartë

Rainer Deville - Ekspert i Nivelit të Lartë

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Mirëdita!

Meqenëse jemi gati, mund të fillojmë mbledhjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Drejtësi. Në rendin e ditës është projektligji i fundit i paketës së shtatë projektligjeve prioritare të reformës kushtetuese. I fundit nga radha, por jo nga rëndësia, sepse projektligjet kanë të gjitha rëndësinë e tyre të veçantë. I tillë është edhe projektligji që do të marrim sot në shqyrtim "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë";

Projektligji ka kohë që është paraqitur, i është nënshtruar një procesi të gjerë konsultimi dhe ka, gjithashtu, kohë që është në faqen zyrtare të reformës dhe të vetë Kuvendit, në mos gaboj, prej gati dy muajsh. Është një projektligj i njohur gjerësisht. Së fundi ka pasur disa komente, që janë bërë edhe pas paraqitjes së këtij varianti, që është depozituar dhe është bërë publik, ndoshta edhe për shkak të ndryshimeve kushtetuese. Disa refleksione vijnë edhe për shkak të ndryshimeve kushtetuese, disa edhe për shkak të harmonizimit me 6 ligjet e tjera, por këto ditë kemi marrë edhe një opinion të kryetarit të Gjykatës Kushtetuese mbi nevojën e disa ndryshimeve të mundshme në vlerësimin e tij lidhur me këtë projekt.

Kështu që fillimisht le të dëgjojmë zotin Sadushi, që do të na bëjë një paraqitje në tërësi, pa u ndalur në detaje sipas neneve, për ndryshimet e grupit ekspertëve, ku konsistojnë ndryshimet kryesore që mund t'i bëhen projektit që ne kemi pasur në dispozicionin, për shkak të ndryshime kushtetuese të 22 korrikut, për shkak të harmonizimit me ligjet e tjera, të paketës së 7 ligjeve prioritare, ku përfshihet edhe ky ligj, natyrisht edhe për shkak të komenteve dhe sugjerimeve të paraqitura nga kryetari i Gjykatës Kushtetuese. Kështu që pasi të dëgjojmë paraqitjen e zotit Sadushi, do t'ju ftoja që të bëni pyetjet ose ndonjë koment tuajin.

Zoti Sadushi e ka fjalën.

Sokol Sadushi – Faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndetje të gjithëve!

Në fakt, është e vërtetë që projektligji është hartuar nga ne mbi draftin kushtetues, mbi ato mundësi që drafti mund të sillte pas miratimit dhe për rrjedhojë drafti ka sjellë disa ndryshime të vogla, që u përshtaten atyre rregullimeve që janë bërë në Kushtetutën e miratuar nga parlamenti shqiptar. Janë pasur në vëmendje edhe disa sugjerime apo vërejtje të

bëra nga ana e kryetarit të Gjykatës Kushtetuese. Unë po përqendrohem në disa nene kryesore të cilat ne ia sugjerojmë komisionit që t'i shohë, me idenë e një përshtatjeje qoftë me normat kushtetuese, qoftë me atë që ne mendojmë se i përshtatet legjislacionit dhe ligjeve të tjera që ju keni miratuar këto kohë dhe që kanë të bëjnë me 7 ligjet kryesore.

Konkretisht nuk po qëndroj në formalitete, por në disa sugjerime konkrete, për të cilat edhe ne jemi të bindur që ndoshta kanë nevojë të ndryshohen mbi sugjerimet që ka dhënë vetë kryetari i Gjykatës Kushtetuese.

Në qoftë se unë duhet të qëndroj në dispozita konkrete, unë mund të qëndroj që tani, mund të qëndroj edhe kur t'i kaloni ju, por në përgjithësi ..

Fatmir Xhafaj – Bëni një herë një paraqitje për komisionin, që pastaj ta çmojë komisioni se si do të ecim më tej.

Sokol Sadushi – Në përgjithësi është parë me një lloj pozitiviteti nga ana jonë, një lloj përputhjeje e shqetësimit që ka kryetari i Gjykatës Kushtetuese, për sa i përket pozicionit që kanë këshilltarët, e lidhur edhe me rolin që kanë këshilltarët në sistemin gjyqësor. Ne duhet të kemi një lloj harmonizimi midis ligjit të statusit të gjyqtarit dhe ligjit të Gjykatës Kushtetuese. Me thënë të drejtën, kjo ka qenë një diçka që nuk ishte gjetur shumë përputhje. Ne jemi vënë në dijeni edhe të projektligjit që ju keni kaluar edhe për seancën e gjyqtari dhe jemi përpjekur që të gjejmë një lloj harmonizimi aq sa është e mundur. Paraprakisht do të kërkoja të qëndroja te një lloj diference që kanë këshilltarët e Gjykatës Kushtetuese nga këshilltarët e zakonshëm, për vetë specifikën që ka Gjykata Kushtetuese, sepse për të qenë të sigurtë nuk është aq e thjeshtë dhe aq e lehtë që në të ardhmen Gjykata Kushtetuese të jetë e përbërë njëqind për qind nga magjistratë, ashtu si me të drejtë është synuar në gjyqësorin e zakonshëm. Në Gjykatën Kushtetuese prania e vetëm magjistarëve është vlerë, sigurisht, por praktikisht në realitetin shqiptar ne e konsiderojmë të pamundur. Ka edhe një arsye tjetër që mund të krijojë edhe një lloj kolapsi, sepse në qoftë se do të kalojnë vetëm magjistratë në Gjykatën Kushtetuese, atëherë është e kuptueshme që kalimi i vetëm magjistratëve në Gjykatën Kushtetuese do të krijojë boshllëqe në gjyqësorin e zakonshëm. Nga ana tjetër, unë flas edhe nga përvoja ime, në Gjykatën Kushtetuese është shumë e rëndësishme që të ketë një përputhje midis magjistratëve, pra ata që vijnë nga gjyqësori i zakonshëm dhe ata që vijnë nga jeta akademike. Gjykata Kushtetuese është një gjykatë që ka nevojë shumë për kërkimin dhe kërkimi është një element, pa mohuar vlerën që kanë magjistratët, gjyqtarët për të kërkuar, por për shkak të ngarkesës së madhe që ata kanë, për të qenë i sigurtë, e kanë pak të vështirë kërkimin, sa e ka ndoshta ai që vjen nga jeta akademike. Kështu që në Gjykatën Kushtetuese një ndërthurje midis këtyre dy momenteve, që lidhen qoftë me sjelljen e përvojës

së, ta them magjistratit, qoftë me marrjen e kërimit bashkëkohor nga jurisprudenca e gjykatave homologe është një vlerë. Dhe në këtë drejtim ne kemi bërë një sugjerim për sa i përket një lloj ndërthurjeje në pjesën e këshilltareve, midis atyre që vijnë nga gjyqësori dhe atyre që vijnë nga jogjyqësori.

Ka një sugjerim nga ana e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese që lidhet me mënyrën e përzgjedhjes qoftë nga Presidenti, qoftë nga Kuvendi, që kur të vijë momenti, unë do të qëndroj dhe ndoshta është një sugjerim që ka vlerë dhe ne e kemi parë si diçka që mund të gjejë një lloj përmirësimi. Bëhet fjalë për ndonjë rast eventual, që mund të ndodhë që një organ të zgjedhë dy gjyqtarë kushtetues. Kjo në normalitet nuk ndodh, sepse përvoja është e tillë që për shkak të rrotacionit në Gjykatën Kushtetuese do të ndodhë që një do të zgjidhet nga Kuvendi, një nga Presidenti dhe një nga Gjykata e Lartë. Por nëse do të ndodhë që në një rast eventual të largohen 4 gjyqtarë nga Gjykata Kushtetuese, atëherë i bie që një organ të ketë dy kandidatura. Pra Presidenti, Kuvendi ose Gjykata e Lartë. Pra, në këtë aspekt ne kemi sugjeruar dhe do t'ua bëjmë me dije kur të vijmë te neni 7, pra kemi një propozim konkret lidhur me këtë ligj.

Ka një sugjerim nga ana e kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, që lidhet me mënyrën e zgjedhjes së kryetarit të Gjykatës Kushtetuese. Sugjerohet që të zgjidhet jo sipas formulës së propozuar nga vetë trupa, por të qëndrohet në formulën ekzistuese, që Presidenti dekretion dhe parlamenti vendos.

Në fakt, një formulë e tillë, është thënë, quhet një formulë e dështuar kështu që kthimi përsëri në formulën e dekretimit nga Presidenti dhe e pëlqimit nga parlamenti për kryetarin e Gjykatës Kushtetuese shkon në kundërshtim me të gjithë rrymën që është ndjekur në përpilimin e të gjithë akteve kushtetuese dhe ligjore, për më tepër që është pranuar që kryetari i Gjykatës së Lartë do të zgjidhet nga vetë trupa, kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor do të zgjidhet nga trupa, kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga trupa, kështu që edhe kryetari i Gjykatës Kushtetuese ne kemi menduar dhe kemi propozuar që të zgjidhet nga vetë trupa.

Sugjerimi që kryetari i Gjykatës Kushtetuese të zgjidhet sipas formulës ekzistuese, në fakt, nuk është në opinion tonë si në zgjidhje e arsyeshme.

Edhe për sa i përket shortit, ne e kemi parashikuar ashtu siç është formula e re në të gjithë gjyqësorin e zakonshëm ndoshta formula ekzistuese, por është vendosur si standard që të gjitha çështjet caktohen me short, Gjykata Kushtetuese ka pasur një specifikë që caktimi i çështjes bëhej nga kryetari dhe ne faktikisht kemi shkuar tek ideja që të caktohet çështja me

short dhe ne këtë kemi bërë si propozim në variantin që ju keni përpara. Sugjerimi i kryetarit është që ndoshta duhet të ngelet përsëri në kompetencën e kryetarit caktimi i çështjeve.

Për sa i përket sugjerimit tjetër që është bërë nga kryetari, lidhet me afatet e shpalljes së vendimit të arsyetuar. Edhe këtu ka një rezervë nga ana jonë, sepse për çështjen e afatit Gjykatat Kushtetuese është kritikuar ose është sulmuar që vendimet i arsyeton me vonesë. Nisur nga ky element që është evidentuar edhe në të gjitha dokumentet e reformës në drejtësi, ne kemi vendosur disa risi në ligj, konkretisht, e para, kur të shkohet në vendimmarrje, Gjykatat Kushtetuese ose trupa do të ketë një projektvendim përpara, ndryshe nga realiteti ekzistues. E dyta, ne kemi shkruar në maksimum afatet ose kemi vendosur afate që Gjykatat Kushtetuese, edhe në se ndodh që mund të shpallë dispozitivin, ajo nuk duhet ta kalojë afatin, sipas rastit, të ndryshme, 3 ditor ose 5 ditor.

Sugjerimi i kryetarit është që të zgjatet afati. Ne kemi opinionin që afatet janë të arsyeshme. Një afat 3 ditor për të arsyetuar vendimin ndoshta mund të jetë edhe pak i zgjatur. Ne nuk mund ta zgjasim më tej. Në raste të tjera të veçanta ka afate të tjera, por e rëndësishme është që ka një afat që ne e amendojmë që është afati më i arsyeshëm i mundshëm. Zgjatja e mëtejshme e këtij afati nuk mendoj se është zgjidhje e pranueshme dhe e arsyeshme.

Ka edhe një shqetësim që është i përligjur dhe ne e gjejmë me vend në sugjerimet që ka bërë kryetari i Gjykatës Kushtetuese lidhur me kohën e hyrjes në fuqi apo me efektin që do të sjellë ligji i ri apo amendamentet e reja. Ne kemi vendosur datën 1 janar për individin kryesisht, që efektet e këtij ligji për individin për nene të veçanta do të fillojnë të zbatohen nga data 1 janar 2017. Ndoshta sugjerohet që ky afat është pak i shkurtër dhe ndoshta kërkohet një lloj zgjatjeje. Ne e lëmë në vlerësimin tuaj, ndoshta ka nevojë për t'u zgjatur pak më tej se sa 1 janari, sepse koha tani ka kaluar, nga koha që është përgatitur projektligji, kuptohet që ndikon në shtyrjen e këtij afati të zbatimit të tij dhe që lidhet edhe me kohën e hyrjes në fuqi. Këto janë disa sugjerime që kryetari i Gjykatës Kushtetuese ka bërë. Unë qëndrova në këto sugjerime, sepse për të qenë të sinqertë ato ishin risi për ne, të tjerat që kanë të bëjnë me përshtatjen sa të jetë e mundur me elemente kushtetuese, ne kemi qenë të detyruar t'i kemi në vëmendje, që lidhen me fazën tranzitore të Gjykatës Kushtetuese, që në periudhën 9-vjeçare që lidhet me veprimin e organit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, do të jetë ky organi që do të kryejë disa funksione në Gjykatën Kushtetuese për sa i përket procedimit disiplinor dhe natyrisht që kjo ka gjetur vend në projektligj.

Këto janë në vija të përgjithshme në vërejtjet e kryetarit. Ndoshta kur të kalojmë në diskutimin nën për nën, mund të ketë edhe detaje lidhur me sugjerimet që ka qoftë kryetari i Gjykatës Kushtetuese, qoftë edhe nga diskutimi që ne kemi pasur në komision.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Kjo ishte një paraqitje e përgjithshme, nuk e di sa të familjarizuar jeni me këto dhe me projektin edhe për shkak të kohës.

Keni ndonjë koment?

Po, zoti Vasili.

Petrit Vasili – Ky ligj që po kalojmë është një ligj i rëndësishëm dhe ka të bëjë me ndryshimet përkatëse të një gjykate, e cila përgjithësisht në raport me pjesë të tjera të sistemit gjyqësor ka demonstruar një integritet, i cili mund të konsiderohet një integritet i veçantë, më i spikatur në raport me pjesët e tjera të sistemit.

Njëkohësisht ne kemi një seri vërejtjesh këtu përpara, të cilat unë i kam parë dhe i kemi konsultuar dhe do të thosha, meqë bëhet fjalë në mënyrë të veçantë për Gjykatën Kushtetuese, ndryshe nga të tjerat, ne kemi pasur rastin këtu në komision të diskutojmë edhe për çështje që kishin të bënin me prokurorinë dhe besoj që do të ishte mirë t'i jepnim pak kohë vetes, pse jo, me të drejtën për të imponuar, por një prezencë nga Gjykata Kushtetuese edhe mund ta mirëprisnim në komision, sikurse e bëmë për prokurorinë, e cila e ndihmoi procesin, nuk e pengoi. Kjo nuk afekton edhe sensin tonë për të ecur përpara me reformën, megjithatë në disa raste edhe këqyrja praktike e gjërave që vëmë në ligj ka edhe vlerën e saj të madhe, sepse siç na e tregojnë disa momente të tjera, në mënyrë të veçantë çështja e afateve na krijoi problem, dhe ne është mirë t'i dalim sa më përpara kësaj gjëje. Së pari.

Së dyti, mendoj që ne në një farë mënyre jemi në pjesën konkluzive të pjesës sonë, por ne kemi njëkohësisht edhe një debat të lënë hapur për disa çështje, të cilat besoj, të paktën nga sa u diskutuan në komision, duket që na çojnë në një përmbyllje, pse jo, edhe me konsensus, të ligjit për Byronë e Hetimit dhe për Prokurorinë e Posaçme, të cilat me dakordësi të përbashkët i kemi lënë të hapura. Këto kërkojnë një kohë të veçantë për t'i përmbyllur në një qëndrim përfundimtar dhe të jemi të bindur në vendimin përfundimtar që do të marrim, pasi vetë kemi rënë dakord që disa riformulime mund të shiheshin, pasi kishin mundësinë edhe të gjetjes së një mirëkuptimi më të gjerë edhe politik.

Së treti, një problem tjetër që unë do të ngrija është që në mënyrë shumë korrekte nga ana juaj është ngritur dhe unë jam informuar që Kuvendi i është drejtuar qeverisë me kërkesën për vlerësim përkatës të faturës financiare, faturë financiare, e cila ka qenë, është një pyetje për ne, por natyrshëm ka qenë edhe një pyetje për opinionin publik, sepse në disa

raste ka shkaktuar edhe debate, të cilat mua jo gjithmonë më janë dukur me ndonjë përmbajtje të madhe, por gjithsesi kanë krijuar një interes, një pikëpërplasje, një mundësi keqinterpretimi në shumë raste dhe sigurisht që qeveria këtë vlerësim të faturës financiare natyrshëm që do të na e sjellë, por ne e kemi të vështirë, thuajse të pamundur të shkojmë në sallën e Kuvendit, të përballemi edhe me pikëpyetje dhe një përgjigje shteruese ne të mos e kemi, sepse Komisioni i Reformës nuk mund ta japë dot këtë përgjigje, sepse nuk e ka në atributet e saj ta bëjë këtë gjë. Kështu që ne jemi të detyruar, duam apo nuk duam ne, ta presim këtë vlerësim dhe të shprehemi edhe këtu edhe politikisht për këtë çështje dhe me ndërgjegjen e plotë që, cilado qoftë fatura financiare në vlerësimin tonë ose në modifikimet që mund t'i bëhen, do të jetë e tillë sepse reforma për të filluar e kërkon këtë financim nga buxheti, i cili mund të jetë më i madh në momentin e startimit të saj, pastaj në rrugë e sipër hyn në një normalitet të ri buxhetor.

Pra, një propozim ishte të rishikonim afatet e përmbylljes së paketës së gjatë ligjeve të mbetura, pasi vetingun e kemi të miratuar e bashkë me këtë të përcaktonim edhe një rikalendarizim, sepse kalendarin themelor e kemi tashmë të realizuar, por për të ecur më tutje, pasi objektivin që ne kemi pasur dhe që ka qenë një objektiv shumë i mirë dhe i shëndetshëm për të ecur drejt seancës në datën 29, mua me duket një objektiv i pamundur pa pasur një përgjigje shteruese dhe serioze për këto momente, qoftë për Gjykatën Kushtetuese sot, qoftë për qëndrimin përfundimtar për Byronë e Hetimit dhe për Prokurorinë e Posaçme, në mënyrë të veçantë për faturën financiare që nuk e kemi. Kështu që do të doja të kisha mirëkuptimin tuaj që ta diskutojmë edhe këtë çështje në komision.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Vasili!

Ka komente nga kolegët?

Unë e gjej me shumë vend ndërhyrjen e zotit Vasili për tre elementet që parashtroi, si për nevojën për të pasur kohë, në mënyrë që të shohim se cilat janë reflektimet më të mira që mund të bëhen edhe në raport me opinionet e sjella për ligjin “Për Gjykatën Kushtetuese”, ashtu edhe me përafrimin ose harmonizimin e tij me ligjet e tjera kuadër të sistemit, që janë pjesë e paketës së ligjeve prioritare.

Pa dyshim, është e rëndësishme që ne të vazhdojmë të tentojmë mundësinë e një konsensusi për një ligj të tillë, të rëndësishëm, siç është ligji “Për Prokurorinë Speciale dhe Byronë Kombëtare të Hetimit”, i cili, pas ligjit për vetingun, është një nga ligjet më të rëndësishme të gjithë kësaj pakete që ne po miratojmë.

Fakti që dispozitat që kishim lënë të hapura vetëm sot janë bërë të vlefshme për t'u diskutuar, por edhe nevojën që kemi për t'i diskutuar këto edhe me kolegët e opozitës, nëse

do t'i bashkëngjiten këtij diskutimi vullnetmirë, detyrohemi t'i japim kohë këtij aspekti. Sapo relatori t'i ketë gati, ai mund t'i shpërndajë bashkë me ekspertët, në këtë rast janë edhe ekspertët vendas, por në mënyrë të veçantë ekspertët ndërkombëtarë, të cilët kanë mbajtur një peshë kryesore në hartimin e këtij projektligji, që kolegët deputetë, të maxhorancës dhe të opozitës, në komision të kenë mundësi të shprehen, gjë që pa dyshim do të kërkojë kohën e nevojshme.

Ajo që është më e rëndësishme nga të gjitha këto, që bie plotësisht dakord me kolegun Vasili, është çështja e vendimmarrjes së Këshillit të Ministrave për faturën financiare. Ne jemi të ndërgjegjshëm që kjo është një faturë financiare që ka efekte jo të vogla, përkundrazi, ka efekte të mëdha në buxhetin e shtetit sot dhe në vitet që vijnë. Është shumë e vërtetë që gjatë gjithë kësaj periudhe ne, ekspertët, sekretariati teknik, por edhe vetë relatorët kemi punuar ngushtësisht me përfaqësuesit e qeverisë, specialistët, drejtorët e caktuar nga Ministria e Financave, Ministria e Mirëqenies Sociale, DAP-i, drejtuesit e ZABGJ-së, drejtuesit e administratës së Prokurorisë së Përgjithshme për t'u dakordësuar me një zgjidhje sa më të mirë, me një zgjidhje të pranueshme për mundësitë që ka buxheti i shtetit, por, njëkohësisht, edhe në funksion të qëllimit që kemi për të bërë një hop cilësor në mbështetjen e sistemit, të gjyqtarëve dhe prokurorëve, me paga shumë më të mira se deri tani, por edhe me përfitime të tjera shtesë, që janë të nevojshme për t'u dhënë atyre shumë garanci, si dhe për t'i mbështetur në punën e tyre të rëndësishme.

Sot që po flasim gjithë ky proces është i mirëkordinuar, është një bërë një punë e përbashkët në tavolinë për këtë gjë. Edhe në mbledhjet e komisionit gjatë momentit të shqyrtimit të ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve" kanë qenë të pranishëm përfaqësuesit e qeverisë. Por është e vërtetë që nuk kemi sot një përgjigje shteruese, zyrtare të Këshillit të Ministrave lidhur me këtë gjë. Ne nuk mund ta vëmë Kuvendin në një pozitë të vështirë sa kohë që nuk kemi një përgjigje përfundimtare për këtë çështje. Nëse do të ketë ndryshime nga ajo që kemi dakordësuar, unë do të kërkoj që të reflektohen tek amendamentet përkatëse të ligjit për statusin. Në këtë kontekst, është e nevojshme që t'i japim kohë vetes për ta pasur këtë vendimmarrje të Këshillit të Ministrave për përgjegjësinë që ai do të marrë për ta reflektuar më pas në buxhetin e shtetit gjithë këtë barrë fiskale, në mënyrë që nëse ka gjëra të minutës së fundit, që do të duhet t'i reflektojmë edhe në amendamentet përkatëse, të mund t'i bëjmë. Kështu që nga kjo pikëpamje e shoh të arsyeshme, nëse ju nuk keni ndonjë kundërshtim, ta ndërpresim këtu, t'u japim kohë kolegëve të njihen edhe me amendamentet.

Do t'u sugjeroja ekspertëve dhe sekretariatit teknik, që kanë punuar me ligjin "Për Gjykatën Kushtetuese" së bashku me relatorin, zotin Majko, të kenë mundësi të bëjnë një

analizë, që ne ta kemi, në lidhje me ndryshimet e mundshme që do të reflektohen në projekt në fund të këtij diskutimi, duke vlerësuar edhe propozimet e sjella, për ta lehtësuar punën e komisionit.

Ndërkohë, relatori, zoti Manja, duhet t'i përmbyllë, së bashku me ekspertët, amendamentet e mbetura nga projektligji për SPAK-un dhe sapo të jenë gati amendamentet shtesë t'u shpërndahen, ndoshta që sot, po të jetë e mundur, nëse arrijnë, por besoj se po, sepse, siç e thatë, ato janë gati, deputetëve, që t'u japim kohën e nevojshme për t'u njohur.

Nga ana tjetër, unë do të vazhdoj, edhe në emër të komisionit, kontaktet me Këshillin e Ministrave për të pasur sa më shpejt të jetë e mundur në dispozicion qëndrimin e tyre lidhur me aspektet financiare të kësaj pakete ligjore.

A jeni dakord? Dakord.

Meqenëse jemi të gjithë dakord me këtë zgjidhje, faleminderit!

Këtu e mbyllim mbledhjen për sot. Në lidhje me orën se kur do të zhvillohet nesër mbledhja e komisionit do t'ju njoftojmë. Gjithashtu do t'ju njoftojmë edhe se kur do të jetë projektligji "Për Gjykatën Kushtetuese".

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA